



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.125, datë 26.05.2022

PËR  
“KUALIFIKIMIN E KANDIDATËVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET PËR  
KANDIDIM PËR NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË  
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6, nenin 52 pika 9, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 4, germa “k”, nenin 8, nenin 9 pika 3 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të kualifikojë kandidatin, zotin Arens Çela, i cili plotëson kushtet për kandidim për ngritjen në detyrë në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimit i bashkëngjitet relacioni shpjegues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.
3. Të njoftojë zotin Arens Çela për këtë Vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti



**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**

**ANËTAR**  
**Ludovik Dodaj**

**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**